



MEMORANDUM BASHKEPUNIMI

NDERMJET

“FEDERATES SHQIPTARE TE PESHKIMIT

SPORTIV”

DHE

“FEDERATES TE PESHKIMIT SPORTIV TE

KOSOVES”



Preambul

Ky memorandum bashkëpunimi lidhet midis:

Federata Shqiptare e Peshkimit Sportiv me adresë: Rr. Hoxha Tahsin, P.Vjero, Tiranë
përfaqësuar nga **Z. Vasjan Lami, President**

Dhe

Federata e Peshkimit Sportiv të Kosovës me adresë: Rr. Adrian Krasniqi, Prishtinë përfaqësuar
nga **Z.Milahim Vitia, President.**

Në vijim të quajtuara *Palë*:

Duke patur parasysh, objektin e veprimtarisë të palëve të këtij memorandum;
Duke marrë në konsideratë, bashkëpunimin në fushën e peshkimit sportiv;
Duke vlerësuar, rëndësinë e realizimit të projekteve të ndryshme sportive;
Duke theksuar rolin e rëndësishëm të ndërveprimit të dy federatave për promovimin dhe zhvillimin e sportit të peshkimit
Federata Shqiptare e Peshkimit Sportiv dhe Federata e Peshkimit Sportiv të Kosovës,

Kane rënë dakord të nënshkruajnë sot, me datë 9 Shtator 2024, këtë memorandum bashkëpunimi, në vijim i quajtuar Memorandumi:

NENI 1 - QELLIMI

1. Qëllimi i këtij memorandum është thellimi i bashkëpunimit midis dy federatave si dhe nxitja e organizimit dhe zhvillimit të aktiviteteve sportive midis anëtarëve të dy federatave.
2. Nepermjet këtij memorandum synohet:
 - a. Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta sportive
 - b. Organizimin e seminareve për ndarjen e eksperiencave në teknikat e ndryshme të peshkimit sportiv
 - c. Trajnimin dhe certifikimin e referëve të peshkimit sportiv në teknikat e ndryshme të peshkimit sportiv



NENI 2 – OBJEKTI I BASHKEPUNIMIT

Palët bashkëpunojnë me njera-tjetrën për hartimin dhe implementimin e programeve të posacme për kryerjen e aktiviteteve sportive, seminareve apo trajnimeve për anëtarët e federatave, sipas roleve dhe përgjegjësi të parashikuara në këtë memorandum. Bashkëpunimi përfshin këto aktivite kryesore:

- a. Organizimin e garës së përbashkët në teknikën e peshkimit me tapë, garë e quajtur **“KUPA E KOMBIT– Peshkim me Tape”** e cila do të zhvillohet cdo vit me pjesëmarrje të anëtarëve nga të dy federatat. Kupa Kombi do të zhvillohet në dy etapa, etapa e parë në Shqipëri dhe etapa e dytë në Kosovë.
- b. Organizimin e garës së përbashkët në teknikën surfcasting, garë e quajtur **“KUPA E KOMBIT – Surfcasting”**, e cila do të zhvillohet në dy etapa brenda ditës, në Shengjin me pjesëmarrje të anëtarëve nga të dy federatat.
- c. Organizime të garave të përbashkëta edhe në teknika të tjera të peshkimit sportiv sipas teknikave të miratuara nga FIPS.
- d. Organizimin e seminareve me qëllim trajnimin e sportistëve përkatesisht, **Federata e Peshkimit Sportiv të Kosovës** organizon seminare për teknikat e peshkimit me tape dhe **Federata Shqiptare e Peshkimit Sportiv** organizon seminare për teknikat Surfcasting, Longcasting, peshkimi nga varka etj.
- e. Organizimin e trajnimeve dhe seminareve të përbashkëta për referet e peshkimit sportiv.
- f. Organizimin e fushatave sensibilizuese dhe informuese për respektimin e periudhave të peshkimit, respektimin e masave minimale, ruajtjen dhe mbrojtjen e ujërave të brendshme dhe bregdetit.
- g. Bashkëpunime të ndryshme që lidhen me peshkimin sportiv, të cilat propozohen nga palët, miratohen nga palët dhe vihen në zbatim nga palët

NENI 3 – ROLI DHE PERGJEGJESITE E PALEVE

Bashkëpunimi sipas këtij memorandumi realizohet si vijon:

Federata Shqiptare e Peshkimit Sportiv ka këto përgjegjësi dhe detyra:

1. Bashkëpunon në realizimin e qëllimeve të këtij memorandumi



2. Në organizimin e “KUPA E KOMBIT– Peshkim me tapë” dhe “KUPA E KOMBIT – Surfcasting” koordinon punën me FPSRK për krijimin e rregullores e cila do të aplikohet gjatë garave.
3. Koordinon punën me FPSRK për sigurimin e referëve dhe gjyqtarëve për organizimin e aktiviteteve sportive të përbashkëta.
4. Koordinon punën me FPSRK për organizimin e seminareve trajnuese në teknikat Surfcasting, Longcasting, Peshkim nga varka etj. FSHPS siguron ambientet e trajnimit si dhe personat që do të zhvillojnë trajnimin.
5. Siguron sportistët anëtarë të FSHPS për të marrë pjesë në garat dhe aktivitetet sportive të përbashkëta.
6. Informon institucionet përkatëse të Republikës së Shqipërisë në lidhje me aktivitetet sportive dhe siguron lejet dhe autorizimet përkatëse për zhvillimin e tyre.
7. Siguron mbarëvajtjen e aktiviteteve sportive dhe çdo aktiviteti tjetër të organizuar brenda Republikës së Shqipërisë.
8. Promovon të gjitha aktivitetet e përbashkëta sportive në faqen zyrtare të FSHPS si dhe në rrjetet sociale.

Federata e Peshkimit Sportiv të Kosovës ka këto përgjegjësi dhe detyra:

1. Bashkëpunon në realizimin e qëllimeve të këtij memorandumi
2. Në organizimin e “KUPA E KOMBIT– Peshkim me tapë” dhe “KUPA E KOMBIT – Surfcasting” koordinon punën me FSHPS për krijimin e rregullores e cila do të aplikohet gjatë garave.
3. Koordinon punën me FSHPS për sigurimin e referëve dhe gjyqtarëve për organizimin e aktiviteteve sportive të përbashkëta.
4. Koordinon punën me FSHPS për organizimin e seminareve trajnuese në teknikat e peshkimit me tapë dhe të gjitha teknikat që lidhen me ujërat e embla. FPSRK siguron ambientet e trajnimit si dhe personat që do të zhvillojnë trajnimin.
5. Siguron sportistët anëtarë të FPSRK për të marrë pjesë në garat dhe aktivitetet sportive të përbashkëta.
6. Informon institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës në lidhje me aktivitetet sportive dhe siguron lejet dhe autorizimet përkatëse për zhvillimin e tyre.



7. Siguron mbarëvajtjen e aktiviteteve sportive dhe cdo aktiviteti tjetër të organizuar brënda Republikës së Kosovës.
8. Promovon të gjitha aktivitetet e përbashkëta sportive në faqen zyrtare të FPSRK si dhe në rrjetet sociale.

NENI 4 – FORMA E BASHKEPUNIMIT

1. Njoftimi i pjesëmarrësve dhe cdo komunikim tjetër, do të kryhet zyrtarisht në adresat zyrtare të strukturës së angazhuar në kuadër të projektit.
2. Struktura e angazhuar do të jetë përgjegjëse për:
 - a- Sigurimin e pjesëmarrësve në aktivitetet sportive, trajnimet dhe aktivitetet e përbashkëta
 - b- Njoftimet dhe mbarëvajtjen gjatë fazës së realizimit të aktiviteteve dypalëshe
 - c- Cdo informacion që lidhet me ecurinë dhe zhvillimin e aktiviteteve

NENI 5 – KOMUNIKIMI MES PALEVE

1. Palët angazhohen të mbajnë komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë cdo informacion për përmbushjen e detyrave të tyre.
2. Palët angazhohen të jenë të disponueshme në cdo kohë për komunikimin dhe koordinimin me njera tjetrën me qëllim koordinimin e veprimeve që duhen të ndermerren rast pas rasti.

NENI 6 – VLERESIMI I ZBATIMIT TE MEMORANDUMIT

Nënshkrimi i këtij memorandumi, fton dhe inkurajon palët në arritjen e të gjitha objektivave të tij në mënyre vullnetare, me qëllim përfundimtar zhvillimin e sportit të peshkimit në Shqipëri dhe Kosovë.

NENI 7 – KOHEZGJATJA E MEMORANDUMIT

Ky memorandum zbatohet për periudhën Shtator 2024 – Shtator 2029.



NENI 8 – BUXHETI DHE SHPENZIMET

Palët koordinojnë punën për hartimin e buxhetit që do të përdoret në organizimin e aktiviteteve sportive të përbashkëta. Buxheti i parashikuar për organizimet do të ndahet në pjesë të barabarta 50 me 50 dhe do të sigurohet nga palët nëpërmjet donacioneve, sponsorizimeve dhe nga anëtarët e federatave.

NENI 9 – ZGJIDHJA E MOSMARRREVESHJEVE

1. Cdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandumi zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.
2. Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (kater) kopje origjinale, nga dy kopje për secilën palë.

NENI 10 – HYRJA NE FUQI

Ky memorandum hyn ne fuqi ne daten e nenshkrimit te tij.

NENSHKRIMET E PALEVE

FEDERATA SHQIPTARE E PESHKIMIT SPORTIV

**PRESIDENT
VASJAN LAMI**

FEDERATA E PESHKIMIT SPORTIV TE KOSOVES

**PRESIDENT
MILAIM VITIA**